VENDIM
Nr.753, datë 9.11.2006

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË DISA TRUPAVE USHTARAKE SLLOVENE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e një njësie ushtarake sllovene, të përbërë nga 6 (gjashtë) trupa dhe 3 (tre) mjete të kalojë transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - Porti i Durrësit - Qafë-Thanë, në datat 14-15 nëntor 2006.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë do të jetë pika e kalimit të kufirit në Qafë-Thanë. Pikat e daljes do të jenë Porti i Durrësit dhe pika e kalimit të kufirit në Qafë-Thanë.

2. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në "Marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave", nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të "Marrëveshjes ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre", nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

3. Trupat sllovene, gjatë itinerarit të lëvizjes, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha